



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/04/24
Datë: 23.04.2024.

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Shpejtim Gacaferi - kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e katërt (04) - e rregullt 2024 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 30.04.2024, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën e parë janar-mars 2024;
4. Ndryshimi i planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2023, sipas programeve;
5. Informatë lidhur me gjendjen e shërbimeve publike në komunën e Junikut;
6. Informatë lidhur me gjendjen e arsimit në komunën e Junikut;
7. Lirimi nga detyra dhe zëvendësimi i anëtarës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës të Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2023;
9. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit;
10. Të ndryshme.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	15.04.2024
PËR/ZA/TO:	Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMEPS/PREKO/THROUGH:	Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës <i>per Shpejtim</i>
NGA/OD/FROM:	Vjollca Qestaj – Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa <i>Shpejtim</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2023, Sipas këtyre programeve



F. hyra vetanake për vitin 2023 sipas planifikimit dhe realizimit

Tabela c planit dhe realizimit:

Nr.	Te hyrat	Planifikimi	Realizimi vjetor 2023	Diferenca (+, -)
1	Te hyrat nga shërbimet kadastrave	13,111.00	9,640.00	-3,471.00
2	Te hyrat nga urbanizmi	8,200.00	0.00	-8,200.00
3	Te hyrat nga administrata	7,200.00	6,052.50	-1,147.50
4	Te hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve	10,300.00	12,937.25	2,637.25
5	Te hyrat nga tatimi ne pronë dhe në tokë	102,019.00	113,499.64	11,480.64
6	Regjistrimi i Automjeteve	6,300.00	8,877.00	2,577.00
7	Te hyrat nga shëndetësia	6,900.00	5,124.50	-1,775.50
8	Te hyrat nga shërbimet e inspektimit	4,200.00	3,233.00	-967.00
9	Të hyrat tjera	1,100.00	7,557.87	6,457.87
	TOTALI	159,330.00	166,921.76	7,591.76

Shuma totale e të hyrave vetanake të inkasuara në periudhën Janar – Dhjetor 2023 duke përfshirë të gjitha të hyrat është gjithsejtë: **166,921.76€**. Shuma e planifikuar për vitin 2023 është **159,330.00€**, ku shifet se kemi tejkallim të inkasimit të të hyrave vetanake për vitin 2023 në vlerë prej **7,591.76€** në këtë shumë janë të përfshira edhe të hyrat nga Gjobat në trafik në shumë prej 7,050.00€ dhe këhimi i mjeteve të pashpenzuara nga viti paraprak në shumë prej 507.87€.

Në mënyrë që të mundemi të alokojmë tejkallimin e të hyrave, kërkojmë që të rritet planifikimi i të hyrave vetanake në shumë prej **7,591.76€**, totali i të hyrave për vitin 2023 të rritet nga 159,330.00€ në 166,921.76€.

Kjo rritje në vlerë prej **7,591.76€**, të bartet si në vijim :

- Nën programi 48020 Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në projektin Bashkëfinancimi i projekteve me kod të projektit 46030 – 7,591.76€.

Ju faleminderojmë për mirëkuptim!



REPublika e Kosovës/REPublika Kosova
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

01/Nr. Prot. 2-955/3489
Një. Org 2
Nr. i faq. 2
Data 19/04/2024



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

DATË/A:	19.04.2024
NR/BR/NO:	7/22
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
CC:	z. Ruzhdi Shehu, Kryetar i Komunës Junik
NGA/OD/FROM:	Xhavit Velijaj- Drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport (DAKRS)
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë lidhur me gjendjen e arsimit në komunën e Junikut.

I nderuar,

DAKRS, duke u bazuar në planin e punës së kuvendit komunal me rend të ditës për Informatë lidhur me gjendjen e arsimit në komunën e Junikut, ka paraqitur të dhëna ekzistuese: planin organizativ, procesin mësimor, fëmijët/ nxënësit, personelit mësimdhënës, personelit menaxhues, personelit teknik, infrastrukture, sigurinë, transportit të nxënësve, dhe aktivitetet, të cilat janë të renditura si më poshtë:

- Procesi mësimor është i organizuar vetëm në ndërrimin e paradites për të gjitha nivelet e arsimit;
- Në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët (SHFMU) “Edmond Hoxha”, nga niveli arsimor 0, vijnë 26 fëmijë të grup moshës 3-5 vjeç dhe 26 fëmijë të grup moshës 5-6 vjeç, ndërsa janë të angazhuara 3 Edukatore;
- Në SHFMU, nga niveli arsimor 1-2, vijnë mësimin 437 nxënës, ndërsa, në proces mësimor dhe menagjerial janë të angazhuar: 38 mësimdhënës, drejtori, sekretari, 4 punëtor teknik dhe 1 mirëmbajtës .
- Në gjimnaz, niveli arsimor 3, vijnë mësimin 159 nxënës, ndërsa, në proces mësimor dhe menaxherial janë të angazhuar: 17 mësimdhënës, drejtori, 1 këshilltar për orientim në karrierë që mbulon te dy nivelet arsimore 2 dhe 3 dhe 1 pedagog i cili poashtu i mbulon te gjitha nivelet e arsimit, dhe 2 punëtor teknik.

- Kemi të angazhuar një psikologe me shërbime të veçanta për të gjitha nivelet arsimore, e cila është e vendosur me zyre në objektin e SHFMU;
- Furnizim është i mirë me materialet shpenzuese higjienike;
- Gjatë sezonit të ngrohjes kemi qenë të furnizuar mjaftueshëm me pelet dhe dru për të dy shkollat duke qene e mirë gjendja me ngrohje;
- Infrastruktura e shkollave është e mirë, janë të pajisura me orendi (banka karrige) duke i përfshirë dollapë për të gjithë nxënësit nga kl.I-V , kabinete të TIK-ut, mjete të punës (didaktike) bazike për lëndët Fizikë, Biologji, Kimi, Matematikë dhe Edukatës fizike;
- Në fillim të muajit dhjetor të vitit të kaluar, procesi mësimor në SHFMU ka filluar në objektin e ri, pasi janë bërë të gjitha përgatitjet;
- Siguria në shkolla është e mirë, kemi kamerat e sigurisë në të dy shkollat;
- Transporti i nxënësve është duke funksionuar normalisht sipas kontratës, nga Lagjja “Agim Ramadani” – SHFMU “Edmond Hoxha”-Gjimnaz “Kuvendi i Junikut” dhe anasjelltas. Policia kujdeset çdo ditë pune për mbarëvajtjen dhe sigurinë e nxënësve në komunikacionit para objektit të SHFMU gjatë hyrjes së nxënësve në oborrin e shkollës, para se të fillojë mësimi.

Aktivitetet

- Gjatë muajit shkurt në SHFMU është kryer Vaksinimi nga QKMF-Junik, për grupmoshat 5-7 vjeç, vaksinonim i rregullt , dhe 11-12 vjeç vakcina për vajza “ kundër kancerit të qafës së mitrës”.
- Në muajin shkurt në SHFMU “Edmond Hoxha” nga policia e Kosovës u mbajt ligjërata me temën “Narkotiket dhe pasojat e drogës”.
- Gjatë muajit shkurt në Gjimnaz “Kuvendi i Junikut” dhe në SHFMU, Forca e Sigurisë së Kosovës ka mbajtur ligjërata me temën “ Mjetet e pa shpërthyer Eksplzivët-Minat”.
- Në muajin shkurt nxënësit e kl. VII₃ duke plotësuar kriterin të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) si paralelja më e mirë, kanë qenë në Brezovicë për 5 ditë, në kuadër të shkollës dimërore të skijimit, projekti “Drejt Malit” në programin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në bashkëpunim të MASHTI , Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sportit Shkollor i Kosovës , ky është viti i dytë që marrin pjesë nxënësit e SHFMU “Edmond Hoxha”.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Pëi/Za/To:	z. Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal në Komunën e Junikut.
Përmes/Prekto/Through:	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunes së Junikut, Kryesues i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
Nga/Od/From:	z. Besart Tofaj - Nënkryetar i Komunes së Junikut, Koordinator i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
Datë/Datum/Date:	12.04.2024
Tema/Subjekat/Subject:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal - zëvendësimin e anëtares në KKSB.

I nderuar,

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2024 është njoftuar për largimin nga puna dhe njëkohësisht nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi të znj. Xhevalire Krasniqi - zyrtare për Barazi Gjinore në kuadër të zyrës së Kryetarit.

Pas largimit të zyrtares së lartpërmendur Kryetarin i Komunës z. Ruzhdi Shehu ka marrë vendim nr 01/01 që deri në rekrutim të zyrtar-it/es këto detyra ti kryej znj. Ariola Krasniqi.

Andaj, propozojmë që përfaqësuese për Barazi Gjinore në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi të jetë znj. Ariola Krasniqi.

Me respekt !



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

01/Nr. Prot. 2-155/3212
Një. Org 2
Nr. i faq. 16
Data 12.04.2024



REPUBLICA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATË/A:	11.04.2024
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	znj. Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në mbledhjen e KPF-së dhe Kuvendit komunal Raportin tremujor financiar për vitin 2024 (Janar-mars)



I nderuar,

Në bazë të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr: 03L/048 neni 45, paragrafi 45.4 ku është detyrë e Egzekutivit që në periudha tremujore dhe vjetore të raportoj para Kuvendit Komunal, atëherë kërkojmë që të shtohet në rend dite në mbledhjen e ardhshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, raporti financiar mbi Buxhetin dhe Shpenzimet për periudhën Janar- mars 2024.

Të bashkëngjitur në kërkesë keni raportin e përgatitur nga Drejtorja për Buxhet dhe Financa.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF
KOSOVO



KOMUNA E JUNIKUT
OPSTINA JUNIK/ MUNICIPALITY OF JUNIK

KOMUNA E JUNIKUT

**RAPORTI I BUXHETIT
KOMUNAL PËR
PERIUDHËN JANAR -
MARS / 2024**

Junik, Prill -2024

KOMUNA E JUNIKUT

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA
Telefon : +381 390 370 112, Centrex. 0038 200/44-504

Informata -I- Financiare Periodike 2024

Kërkesat për raportim

Informata Financiare Komunale për periudhën Janar – Mars 2024, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e neneve 46.1 dhe 46.2 të Ligjit Nr. 03/L-048 “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” dhe statutit Komunal.

Informata Financiare Komunale Periodike ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesve do të prezantohet për 14 programet buxhetore :

1. Zyra e Kryetarit
2. Kuvendi Komunal
3. Administrata e Përgjithshme
4. Buxhet dhe Financa
5. Zhvillim Ekonomik
6. Shërbimet publike dhe Inspeksion
7. Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis
8. ZKK (Zyra Komunale për Komunitete)
9. Shëndetësi
10. Mirëqenie Sociale
11. Shërbimet e kujdesit primar
12. Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
13. Arsimi i mesëm
14. Arsimi fillor

TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PERIODIKE

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik) të bazuar në para të gatshme “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”. Shënimet në pasqyrat financiare paraqesin pjesë integrale për ta kuptuar pasqyrën, andaj duhet të lexohen së bashku me pasqyrat.

Pasqyrat financiare janë për Komunën e Junikut. Komuna e Junikut kontrollohet nga Qeveria e Kosovës dhe të gjitha aktivitetet e saja financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Komuna e Junikut nuk operon me llogarinë e vet bankare. Qeveria operon me funksion të centralizuar të Thesarit i cili e administron pranimin e parave të gatshme të mbledhura nga të gjitha entitetet buxhetore gjatë vitit financiar. Pagesat e bëra në këtë llogari sa i përket Komunës së Junikut janë të paraqitura në kolonën e llogarisë së vetme të Thesarit në Pasqyrën e Pranimeve dhe pagesave të Parave të Gatshme.

Buxheti i aprovuar në Asamblenë Komunale për vitin 2024 është në vlerë **2,199,836.93€** i cili ka pësuar ndryshime gjatë periudhës Janar – Mars 2024 për të hyrat nga donacionet dhe donacionet e bartura nga viti 2023 në vlerë **2,469.85€**, Buxheti përfundimtar i përgjithshëm duke përfshirë edhe donacionet është në vlerë **2,202,306.78€**.

Raport i ekzekutimit të Buxhetit

	Buxheti fillestar	Buxheti Aktual	Pranimet - Alokimet	Pagesat (Shpenzimi)	Progresi me plan	% me alokim
Përshkrimi	Ligji Nr. 08-L-260	SIMFK	SIMFK		në, %	në, %
a	b	c	d	e	f=e/c	g=e/d
Gjithsej Pagesat	1+2+3+4+5	1+2+3+4+5	1+2+3+4	1+2+3+4+5		
Totali	2,199,836.93	2,202,306.78	946,766.71	436,610.87	19.83%	46.12%
Paga dhe Meditje	1,445,892.93	1,445,892.93	379,638.00	369,417.29	25.55%	97.31%
Mallrat dhe Shërbimet	246,660.00	246,677.50	242,464.50	42,659.78	17.29%	17.59%
Shpenzimet Komunale	38,500.00	38,500.00	38,500.00	10,110.26	26.26%	26.26%
Subvencione dhe Transferet	62,000.00	62,000.00	30,000.00	668.04	1.08%	2.23%
Investimet Kapitale	406,784.00	409,236.35	256,164.21	13,755.50	3.36%	5.37%
Granti i Përgjithshëm	1 1,991,780.93	1,991,780.93	925,526.00	436,610.87	21.92%	47.17%
Paga dhe Meditje	1,445,892.93	1,445,892.93	379,638.00	369,417.29	25.55%	97.31%
Mallrat dhe Shërbimet	241,660.00	241,660.00	241,660.00	42,659.78	17.65%	17.65%
Shpenzimet Komunale	38,500.00	38,500.00	38,500.00	10,110.26	26.26%	26.26%
Subvencione dhe Transferet	30,000.00	30,000.00	30,000.00	668.04	2.23%	2.23%
Investimet Kapitale	235,728.00	235,728.00	235,728.00	13,755.50	5.84%	5.84%
Rezerva	2 -	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Investimet Kapitale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Të hyrat vetanake	3 208,056.00	208,056.00	18,770.86	-	0.00%	0.00%
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet	5,000.00	5,000.00	787.00	-	0.00%	0.00%
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet	32,000.00	32,000.00	-	-	0.00%	#DIV/0!
Investimet Kapitale	171,056.00	171,056.00	17,983.86	-	0.00%	0.00%
Mjetet e bartura	4 -	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Investimet Kapitale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Grantet - Donacionet	5 -	2,469.85	2,469.85	-	0.00%	0.00%
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet	-	17.50	17.50	-	0.00%	0.00%
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Investimet Kapitale	-	2,452.35	2,452.35	-	0.00%	0.00%


Gjatë këtij tre mujori të vitit 2024 ka ndryshime në mes të buxhetit fillestar dhe aktual siç janë: Transferi i donacioneve në shumë totale **2,469.85 €**, prej tyre **260.98 €** nga **UN-HABITAT** janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale, **17.50 €** nga **KOSTT** në kategorinë Mallra dhe shërbime, **356.50€** nga **SAVE THE CHILDREN** janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale, **1,834.87€** nga **DEMOS** dhe **SIDA** janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale .

TË HYRAT BUXHETORE 2024

Pasqyra aktuale Buxhetore 2024, si dhe pasqyrat finale buxhetore për vitet paraprake
Tabela - 2

Burimi i mjeteve	Pranimet 2021	Pranimet 2022	Pranimet 2023	Pranimet 2024	Progresi 24/23	Progresi 24/22
1	2	3	4	5	7=5/4	8=5/3
Grandi Qeveritar	1,429,991.93	1,504,580.68	1,720,090.49	1,991,780.93	115.80%	132.38%
Të hyrat vetanake	122,802.00	159,038.00	159,330.00	208,056.00	130.58%	130.82%
Mjetet e Bartura	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Donacionet	2,469.85	2,469.85	2,469.85	2,469.85	100.00%	100.00%
Gjithsej	1,555,263.78	1,666,088.53	1,881,890.34	2,202,306.78	117.03%	132.18%

GRAFIKONI I BURIMEVE FINANCIARE KOMUNALE (% E PJESMARRJES)




TË HYRAT PERIODIKE NGA GRANTI I QEVERISË

Klasifikimi ekonomik	2024	2023	2022	2021
	BKK	BKK	BKK	BKK
	€ '	€ '	€ '	€ '
Pagat dhe rrogat	1,445,892.93	1,172,980.49	1,159,638.68	1,153,888.93
Mallrat dhe shërbimet	241,660.00	232,840.00	196,580.00	166,900.00
Shërbimet komunale	38,500.00	37,700.00	36,200.00	36,200.00
Subvencionet dhe transferet	30,000.00	20,000.00	20,000.00	-
Shpenzimet kapitale	235,728.00	256,570.00	92,162.00	73,003.00
	1,991,780.93	1,720,090.49	1,504,580.68	1,429,991.93

TË HYRAT VETANAKE PERIODIKE 2024


Përveç Grandeve të marra nga niveli qendror, për qëllimet e shpenzimeve të përgjithshme, Komuna ka grumbulluar edhe të hyra vetanake. Ekzistojnë disa kategori kryesore të hyrave vetanake komunale: Tatimi në pronë, Te hyrat nga Shëndetësia, Te hyrat nga Regjistrimi i Automjeteve etj.... Të hyrat totale vetanake të grumbulluara Janar - Mars 2024 kanë arritur në shumën prej **32,997.62 €** që përbën **15.86%** të planifikimit vjetor (**208,056,00€**).

GRAFIKONI I TË HYRAVE VETANAKE PËRIDIKE 2021 - 2024



Të hyrat vetanake kryesore periodike Janar – Mars 2024

Te Hyrat nga:	Realizimi 2021	Realizimi 2022	Realizimi 2023	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Progresi me plan.	Progresi me /2023	Progresi me /2022	% në total
	1	2	3	4	5	6 = 5 / 4	7 = 5 / 3	8 = 5 / 2	7= 5/total
Tatimi në pronë	25,329.10	24,693.28	19,599.51	127,505.00	24,171.00	19%	123%	98%	73.3%
Te hyrat nga Shendetsia	794.50	1,158.50	1,055.50	8,000.00	1,073.00	13%	102%	93%	3.3%
Te hyrat nga Administrata	1,329.00	1,817.50	1,594.00	8,000.00	1,670.00	21%	105%	92%	5.1%
Regjistrimi i Automjeteve	1,180.00	1,809.50	2,050.00	8,000.00	2,130.00	27%	104%	118%	6.5%
Te hyrat nga Gjobat ne trafik	915.00	1,157.50	1,500.00	-	-	#DIV/0!	0%	0%	0.0%
Te hyrat nga lejet per ushtrim te veprimtarise	176.00	560.00	5,156.25	15,000.00	570.00	4%	11%	102%	1.7%
Te hyrat nga Urbanizmi	2,788.00	1,755.50	2,676.00	32,001.00	3,195.62	10%	119%	182%	9.7%
Të hyrat tjera	2,230.00	885.00	893.00	9,550.00	188.00	2%	21%	21%	0.6%
Totali	34,741.60	33,836.78	34,524.26	208,056.00	32,997.62	16%	96%	98%	100%



Ne kategorinë Të hyrat tjera bëjnë pjesë: (Të hyrat nga Qiraja 00.00€, Të hyrat nga shërbimet publike-inspeksioni 188.00 €) gjithsejtë **188.00€**

Periudha Janar - Mars 2024 karakterizohet me një realizim të të hyrave në total 32,997.62 € apo 15.86% në raport me planifikimin vjetor, ndërsa krahasuar me vitin paraprak 2023 kemi realizuar 95.58% apo 4.42% më pak, shprehur në vlerë monetare diferenca është 1,526.64 € më pak.

Ne këtë raport nuk janë të përfshira te hyrat nga gjobat e trafikut për periudhën Janar - Mars 2024 pasi qe nuk janë alokuar akoma.


SHPENZIMET BUXHETORE 2024

Planifikimi Buxhetor për 2024 duke përfshirë edhe donacionet është **2,202,306.78€**, gjatë kësaj periudhe janë alokuar mjete në vlerë **946,766.71€** ndërsa janë shpenzuar **436,610.87€**, apo **46.12%** e buxhetit të alokuar.

Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike.

Nr	Përshkrimi	2021	2022	2023	2024	Alokimet TMI/24	Progresi %	
							8=6/5	9=6/7
1	2	3	4	5	6	7		
1	Pagat	300,070.91	259,134.84	339,483.08	369,417.29	379,638.00	108.82%	97.31%
2	Mallra e shërbime	31,590.54	96,064.71	22,335.76	42,659.78	242,464.50	190.99%	17.59%
3	Shpenzi. komunale	6,429.39	8,708.55	9,009.30	10,110.26	38,500.00	112.22%	26.26%
4	Subvencione	500.00	7,400.00	500.00	668.04	30,000.00	133.61%	2.23%
5	Shpenzi. Kapitale	15,000.00	-	-	13,755.50	256,164.21	#DIV/0!	5.37%
Totali		353,590.84	371,308.10	371,328.14	436,610.87	946,766.71	117.58%	46.12%

GRAFIKONI I SHPENZIMEVE DHE % E PJESMARRJES NË SHPENZIMET



- Pagat dhe mëditjet të alokuara në vlerë 379,638.00€ janë shpenzuar 369,417.29€ apo 97.31% e mjeteve të alokuara. Krahasuar me vitin paraprak shpenzimi në këtë kategori është më i lartë për 8.82% për shkak ndikimit të ndryshimeve pas hyrjes ne fuqi te ligjit te pagave ne muajin shkurt 2023. Pjesëmarrja e pagave në shpenzimin e përgjithshëm Komunal është 84.61% .
- Mallrat & shërbimet të alokuara në vlerë 242,464.50€ janë shpenzuar 42,659.78€ në përqindje 17.59% e mjeteve të alokuara. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të larta për 90.99%. Pjesëmarrja e Mallrave & Shërbimeve në shpenzimin e përgjithshëm Komunal është 9.77%.
- Shpenzimet komunale - Komunalit të alokuara në vlerë 38,500.00€ janë shpenzuar 10,110.26€ ose në shkallën prej 26.26% të mjeteve të alokuara. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të larta për 12.22%. Pjesëmarrja e shpenzimeve komunale në shpenzimin total komunal është 2.32%.
- Subvencionet të alokuara në vlerë 30,000.00€ janë shpenzuar 668.04€ ose në shkallën prej 2.23% të mjeteve të alokuara. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të larta për 33.61%. Pjesëmarrja e shpenzimeve te subvencioneve në shpenzimin total komunal është 0.15%.
- Shpenzimet kapitale të alokuara në vlerë prej 256,164.21€ janë shpenzuar 13,755.50€ ose në shkallën prej 5.37% të mjeteve të alokuara. Krahasuar me vitin paraprak nuk kemi pasur shpenzime në këtë periudhë. Pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale në shpenzimin total komunal është 3.15%.
- Në total mjetet e alokuara për periudhën tremujore të vitit 2024 në vlerë prej 946,766.71€ janë shpenzuar në vlerë prej 436,610.87€ ose në shkallën 46.12% të mjeteve të alokuara, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023 shpenzimet janë më të larta për 17.58%.

RAPORTI DETAL I SHPENZIMEVE NË PAGA , MALLA & SHERBIME SIPAS DREJTORIVE

Përshkrimi	Z.Kryetarit	Administrata	Zh. Ekono.	Sh. Publike	K. Komunal	B.Financa	Urbanizem
Paga neto	16,108.01	18,715.20	12,114.39	12,803.82	24,291.39	14,180.88	10,701.63
Tatimi në paga	1,449.54	1,001.78	772.76	951.60	1,940.26	935.67	826.30
Kontributi pensional i punëtorëve	976.37	1,107.30	702.34	746.19	1,643.72	826.56	496.79
Sindikatat							
Odat Profesionale							
Përvoja e punes	673.46	799.65	356.39	422.25	92.64	587.70	598.18
Kontributi pensional i Punëdhënësit	976.37	1,107.30	702.34	746.19	1,643.72	826.56	496.79
Shtesa e veqant per te zgjedhurit					4,904.79		
Kujdestaria, puna jasht orarit te punes, puna	-	353.23	101.16				
Shtesa Tranzitore	926.03	167.99					
Vendim gjykate	-						
TOTALI I PAGAVE & MED.	21,109.78	23,252.45	14,749.38	15,670.05	34,516.52	17,357.37	13,119.69
Shpenzimet e udhtimit në Vendë	-			-	-	-	-
Shpenzimet e udhet. Jashtë Vëndit		-				-	-
Shpenzimet e internetit	-	-	-	-	-	15.00	-
Telefonia Mobile	248.59	210.28	72.00	109.25		160.96	114.87
Sherbimet Postare		29.40					
Sherbimet e perfaqesimit avokatur		1,398.00					
Sherbimet e ndryshme Shendetore							
Sherbimet e veqanta - konsulent dhe kontrakt	-						
Shërbime shtypje / printimit							
Shërbime kontraktuese tjera							
Shërbime teknike	-		-	-	-	-	-
Shpenzimet per anëtaresim	912.60	-		-	-	-	-
Mobile me pak se 1000€							
Kompjuterë me pak se 1000€							
Makina fotokopjuese							
Pajisje trafiku me pak se 1000€							
Pajisje tjera me pak se 1000€						142.00	
Furnizim i Zyrës		350.00					
Furnizim me ushqim dhe pije	348.78	56.04		37.45			-
Furnizimet mjeksore							
Furnizim e pastrimit							
Shpenzimet e veshmbathjes							
Akomodimi							
Vaj							
Nafta për ngrohje							
Dru dhe prodhimet e drurit per ngrohje							
Derivate për automjete, Gjenerator dhe makina	728.65	344.73		482.83		94.06	70.53
Avans për para te imet (patty cash)		500.00					
Regjistrimi dhe sig.automjeteve						-	
Taksa komunale e rexe.automjetit							
Sigur.I ndërtesave dhe të tjerave							
Mirëm. dhe riparim i automjeteve							
Mirëmbajtja e ndërtesave							
Mirëmbajtja e rrugëve lokale				3,800.00			
Mirmb.e teknologjisë informatike							
Mirëmbajtja e mobileve&pajisjeve		900.00					
Mirmbajtja rutinore							596.50
Qiraja							660.00
Reklammat dhe konkurset	-	-					
Botime dhe publikime	-			-	-	-	-
Kompensim i perfaqesimit brenda vendit	199.50	600.00	30.50	122.00			86.00
Vendim gjykate							
Pagesa Per Tarifa - Vendime gjyqsore permbl	-					34.22	
Pag.neni 39.2 LMFPF							
TOTALI M & SH	2,438.12	4,388.45	102.50	4,551.53	-	446.24	1,527.90

RAPORTI DETAL I SHPENZIMEVE NË PAGA , MALLA & SHERBIME SIPAS DREJTORIVE

Përshkrimi	Ad. Arsim	Ars. fillor	A. i mesem	Ad. Shendet.	QKMF	Sh. Sociale	ZLK	Totali periodik 2024
Paga neto	7,853.01	77,369.48	29,097.06	2,357.05	55,028.74	2,554.74	1,632.93	284,808.33
Tatimi në paga	606.60	5,315.48	2,035.09	198.06	4,319.48	150.99	114.24	20,617.85
Kontributi pensional i punëtorëve	459.48	4,538.68	1,733.97	145.19	3,321.46	148.50	95.19	16,941.74
Sindikatat		212.96	104.32					317.28
Odat Profesionale					1,007.43			1,007.43
Përvoja e punes	270.45	3,175.12	1,547.33	203.31	2,610.46	115.41	61.26	11,513.61
Kontributi pensional i Punëdhënësit	459.48	4,538.68	1,733.97	145.19	3,321.46	148.50	95.19	16,941.74
Shtesa e veqant per te zgjedhurit								4,904.79
Kujdestaria, puna jasht orarit te punes, puna	-	158.22	159.82		141.90			914.33
Shtesa Transitore								1,094.02
Vendim gjykate			10,356.17					10,356.17
TOTALI I PAGAVE & MED.	9,649.02	95,308.62	46,767.73	3,048.80	69,750.93	3,118.14	1,998.81	369,417.29
Shpenzimet e udhimit në Vendë	-							-
Shpenzimet e udhet. Jashtë Vendi						104.00		104.00
Shpenzimet e internetit								15.00
Telefonia Mobile		71.06	170.80	41.24	66.09		-	1,265.14
Sherbimet Postare								29.40
Sherbimet e perfaqesimit avokatur								1,398.00
Sherbimet e ndryshme Shendetore					105.00			105.00
Sherbimet e veqanta - konsulent dhe kontrakt	-				20,612.40			20,612.40
Shërbime shtypje / printimit								-
Shërbime kontraktuese tjera		2,884.20					-	2,884.20
Shërbime teknike								-
Shpenzimet per anëtaresim								912.60
Mobile me pak se 1000€			1,404.00					1,404.00
Kompjuterë me pak se 1000€								-
Makina fotokopjuese								-
Pajisje trafiku me pak se 1000€								-
Pajisje tjera me pak se 1000€								142.00
Furnizim i Zyrës								350.00
Furnizim me ushqim dhe pije								442.27
Furnizimet mjeksore								-
Furnizim e pastrimit								-
Shpenzimet e veshmbathjes								-
Akomodimi								-
Vaj								-
Nafta për ngrohje								-
Dru dhe prodhimet e drurit per ngrohje								-
Derivate për automjete, Gjenerator dhe makir	235.73				227.41		-	2,183.94
Avans për para te imet (patty cash)			250.00					750.00
Regjistrimi dhe sig.automjeteve					338.10			338.10
Taksa komunale e rexh.automjetit								-
Sigur.I ndërtesave dhe të tjerave								-
Mirëm. dhe riparim i automjeteve	-	-	-				-	-
Mirëmbajtja e ndërtesave								-
Mirëmbajtja e rrugëve lokale								3,800.00
Mirmb.e teknologjisë informatike								-
Mirëmbajtja e mobileve&pajisjeve								900.00
Mirmbajtja rutinore								596.50
Qiraja								660.00
Reklammat dhe konkurset								-
Botime dhe publikime								-
Kompensim i perfaqesimit brenda vendit	803.01	1,892.00						3,733.01
Vendim gjykate								-
Pagesa Per Tarifa - Vendime gjyqsore permb	-							34.22
Pag.neni 39.2 LMFPP								-
TOTALI M & SH	1,038.74	4,847.26	1,824.80	41.24	21,349.00	104.00	-	42,659.78

SHPENZIMET ANALITIKE KOMUNALIVE, SUBVENCIONEVE DHE INVESTIMEVE KAPITALE

Përshkrimi	Z.Kryetarit	Administrata	Zh. Ekono.	Sh. Publike	K. Komunal	B.Financa	Urbanizem
Shpenzimet e energjisë elektrike		1,237.12	32.49	3,089.59	-		
Shpenzimet e Ujët		33.69	12.96	97.81	-		
Shpenzimet e Mbeturinave	-			792.00	-	-	-
Shpenzimet e Ngrohjes							
Shpenzimet Telefonike	37.32	13.50		98.94	-	21.39	
Pagesa Vendime gjyqsore		-	-	-	-	-	-
TOTALI KOMUNALËVE	37.32	1,284.31	45.45	4,078.34	-	21.39	-
Subvencionet per etnitetet publike							
Subvencionet per etnitetet jopublike	668.04						
TOTALI SUBVENCIONEVE	668.04	-	-	-	-	-	-
Ndërtesa te banuara							
Objekte Arsimore							
Objektet kuturore							
Objektet shendetesore							
Auto Rrugëve							
Rrugët Lokale			6,207.00				
Trotuaret							
Kanalizimi							7,548.50
Ujësjiellësi							
Furniz.Rrymë							
Pajsje speciale mjeksore							
Pajisje tjera							
Mirmbajtja investive							
automjete transporti (autoambulanca)							
Transaksione Kapitale - enti. Publ.							
Pag.neni 39.2 LMFPF							
Vendim gjykate							
TOTALI I INVESTIMEVE	-	-	6,207.00	-	-	-	7,548.50
TOTALI I PËRGJITHSHËM	24,253.26	28,925.21	21,104.33	24,299.92	34,516.52	17,825.00	22,196.09

Përshkrimi	Ad. Arsim	Ars. fillor	A. i mesem	Ad. Shendet.	QKMF	Sh. Sociale	ZLK	Totali periodik 2024
Shpenzimet e energjisë elektrike		441.84	716.64		1,371.15	11.01		6,899.84
Shpenzimet e Ujët		365.30	200.76	-	73.31	16.48	-	800.31
Shpenzimet e Mbeturinave		336.00	336.00	-	504.00		-	1,968.00
Shpenzimet e Ngrohjes								-
Shpenzimet Telefonike		85.07	74.95	-	68.97	41.97	-	442.11
Pagesa Vendime gjyqsore								-
TOTALI KOMUNALËVE	-	1,228.21	1,328.35	-	2,017.43	69.46	-	10,110.26
Subvencionet per etnitetet publike								-
Subvencionet per etnitetet jopublike								668.04
TOTALI SUBVENCIONEVE	-	-	-	-	-	-	-	668.04
Ndërtesa te banuara								-
Objekte Arsimore								-
Objektet kuturore								-
Objektet shendetesore								-
Auto Rrugëve								-
Rrugët Lokale								6,207.00
Trotuaret								-
Kanalizimi								7,548.50
Ujësjiellësi								-
Furniz.Rrymë								-
Pajsje speciale mjeksore								-
Pajisje tjera								-
Mirmbajtja investive								-
automjete transporti (autoambulanca)								-
Transaksione Kapitale - enti. Publ.								-
Pag.neni 39.2 LMFPF								-
Vendim gjykate								-
TOTALI I INVESTIMEVE	-	-	-	-	-	-	-	13,755.50
TOTALI I PËRGJITHSHËM	10,687.76	101,384.09	49,920.88	3,090.04	93,117.36	3,291.60	1,998.81	436,610.87

Shënime shpjeguese:

Në totalin e pagave të shpenzuara në vlerë prej **369,417.29€** janë nga granti i përgjithshëm, për pagesën e pagave të punëtorëve në listën e pagave, Mëditjet e komiteteve, shtesat e veçanta dhe vendimet gjyqësore nga Kontrata kolektive e Arsimit .

Kategoria e Mallrave dhe shërbimeve të shpenzuara në vlerë prej **42,659.78€** të gjitha janë nga granti i përgjithshëm.

Kategoria e Komunalive të shpenzuara në vlerë prej **10,110.26€** të gjitha janë nga granti i përgjithshëm.


Kategoria e Subvencioneve të shpenzuara në vlerë prej **668.04€** të gjitha janë nga granti i përgjithshëm.

Kategoria e Investimeve Kapitale të shpenzuara në vlerë prej **13,755.50€** të gjitha janë nga granti i përgjithshëm.

Shpenzimet sipas Drejtorive dhe progresi me periudhën e njëjtë të viteve paraprake

Shpenzimet Periodike sipas Drejtorive 2021-2024								
	Drejtoritë	2021	2022	2023	2024	Alokimet TMI 2024	Progr. / alokim	Progr. me 2023
1	Zyra e Kryetarit	20,072.85	27,301.30	22,178.12	24,253.26	61,125.00	39.7%	109.4%
2	Kuvendi Komunal	13,851.50	12,222.87	28,015.80	34,516.52	38,516.52	89.6%	123.2%
3	Administratë	29,858.13	51,670.37	29,339.11	28,925.21	85,978.67	33.6%	98.6%
4	Buxhet dhe Financa	15,854.74	15,570.01	13,757.61	17,825.00	25,657.37	69.5%	129.6%
5	Zhvillimi Ekonomik	19,715.38	15,388.05	15,022.01	21,104.33	110,539.55	19.1%	140.5%
6	Sh.publike	37,838.64	41,113.18	17,633.68	24,299.92	112,905.09	21.5%	137.8%
7	Planifikimi urban	12,278.47	13,167.50	15,682.22	22,196.09	136,021.94	16.3%	141.5%
8	ZKK	-	1,681.71	1,322.09	1,998.81	1,998.81	100.0%	151.2%
9	Shendetsia	69,860.48	70,005.57	76,511.38	99,499.00	147,241.89	67.6%	130.0%
12	Arsimi	134,260.65	123,187.54	151,866.12	161,992.73	226,781.87	71.4%	106.7%
Totali Buxhetor		353,590.84	371,308.10	371,328.14	436,610.87	946,766.71	46.1%	117.6%

GRAFIKONI I SHPENZIMEVE TE DREJTORIVE SI DHE PJESMARRJA NE SHPENZIMIN TOTAL



Në kuadër të Shëndetësisë janë të përfshira: Drejtoria e Shëndetësisë (Administrata), QKMF dhe Shërbimet Sociale.

Në kuadër të Arsimit janë të përfshira: Drejtoria e Arsimit (Administrata), Arsimi fillor dhe Arsimi i mesëm.

❖ Progresi i shpenzimeve kapitale sipas projekteve për vitin 2024

Emri i projektit	Kodi i projektit në Thesar	Buxheti 2024	Alokimet TM1/ 2024	Shpenzimet aktuale I - III / 2024	Struktura në %
	1	2	3	4	5
Bashkefinancim I projekteve	46030	102,458.00	67,385.86	6,207.00	9.21
Rehabilitim I rrugeve Lokale ne qytetin e Junikut	53896	20,000.00	10,000.00		-
Kanalizimi I ujrave te zeza lokacioni Moronice Lagja K	53946	9,326.00	9,326.00	7,548.50	80.94
Rregullimi I infrastruktures se oborrit te SHFMU E. H	54996	10,000.00	5,000.00		-
Ndertimi I rrethojës dhe Rikonstruimi I oborrit te staci	55002	7,000.00	5,000.00		-
Ndertimi I Kanaleve te ujitjes Lagja Pepsh, Krraku, Ar	55004	20,000.00	10,000.00		-
Vendosja e Kamerave te Sigurise ne Komunen e Jun	55006	25,000.00	15,000.00		-
Ndertimi I rrjetit te ndriqimit publik ne rruget lokale jur	55010	20,000.00	10,000.00		-
Rregullimi I infrastruktures per deponine e mbeturinat	55012	20,000.00	10,000.00	-	-
Zerimi I Salles se Kuvendit Komunal	55013	13,000.00	10,000.00	-	-
Rekonstruimi I oborrit ne QKMF	55014	10,000.00	7,000.00	-	-
Ndertimi I Sheshit te qendres se Komunes se Junikut	55028	150,000.00	95,000.00	-	-
Permiresim I qas.kujde.zhvill. Gjate femijerise	94618	356.50	356.50	-	-
Participim I projekteve	88351	260.98	260.98	-	-
Ngritja e performances	92052	1,834.87	1,834.87	-	-
Totali		409,236.35	256,164.21	13,755.50	5.37

**Në Projektin bashkëfinancim i projekteve në vlerë prej 6,207.00€ janë të përfshira: Ndërtimi i urës që lidhë Komunën e Junikut me ekofshtrat Gjocaj dhe Jasiq – punët shtese ne bashkëfinancim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.*

Mjetet e alokuara për Investime kapitale janë 256,164.21€ nga këto burime:

- Grandi 235,728.00€ + Te hyrat vetanake 17,983.86€ dhe 2,452.35€ nga donacionet.

Realizimi i buxhetit për investime kapitale në total është 13,755.50€ , prej tyre (13,755.50€ nga Grandi + 0.00€ nga të hyrat vetanake + 0.00€ nga të hyrat e bartura dhe 0.00€ nga Donacionet).

Progresi i realizimit te investimeve Kapitale karshi mjeteve të alokuara për periudhën Janar – Mars të vitit 2024 është 5.37% .

PASQYRA E OBLIGIMEVE TË PA PAGUARA JANAR– MARS 2024

Programet Buxhetore	M&SH	Komunali	Subvencione	Kapitale	Gjithsej	Borgji momental	Pagesa deri me 00/00/24
	6,857.87	2,248.83	-	-	9,106.70		
					-		-
					-		-
					-		-
GJITHSEJ	6,857.87	2,248.83	-	-	9,106.70	-	-

Të arkëtueshmet

		2024
Kodi ekonomik	Përshkrimi	€ '000
40110	Tatim ne prone	322,002.88
50019	Licenca (Ushtrimi i veprimtarisë)	76,427.18
50408	Qiraja nga objektet publike	1,650.00
Gjithsej		400,080.06

❖ REKAPITULLIMI I INFORMATËS FINANCIARE

Kjo informatë periodike Janar – Mars / 2024 ka për qëllim informimin detal dhe objektiv për të gjithë treguesit financiar, qofshin pozitive apo negative.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është që rezultatet pozitive të menaxhimit të këtij buxheti ti forcojmë dhe ti rrisim më tutje, ndërsa treguesit negativë ti eliminojmë gjatë periudhave në vijim. E tërë kjo me qëllim që të jemi sa më të suksesshëm në realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për qëllimet e përcaktuara me planet dinamike të veprimit sipas ligjit mbi Buxhetin.

❖ PLANIFIKIMI BUXHETOR JANAR - MARS 2024

Buxheti fillestar i aprovuar nga Kuvendi Komunal në vlerë **2,199,836.93€** ka pasur ndryshime – rritje në periudhën Janar - Mars 2024 për: **2,469.85€**, nga mjetet e pranuar nga donacionet dhe donacionet e bartura nga viti 2023. Do të thotë buxheti total për vitin 2024 ka vlerën: **2,202,306.78€**.

❖ SHPENZIMET BUXHETORE PERIODIKE JANAR - MARS 2024

- **Shpenzimet nga Grandi qeveritar:** Mjetet e alokuara nga ky burim janë **925,526.00€**, janë shpenzuar **436,610.87€** që do të thotë **47.17%** të mjeteve të alokuara.
- **Shpenzimet nga të hyrat vetanake:** Mjetet e alokuara nga ky burim janë **18,770.86€**, janë shpenzuar **0.00 €** që do të thotë **0,00%** të mjeteve të alokuara.
- **Shpenzimet nga Mjetet e bartura të viti paraprak:** Nuk janë të bartura ne këtë periudhë të raportimit.
- **Shpenzimet nga Donacionet dhe Participimet:** Nga mjetet e pranuar në vlerë **2.469.85€** janë shpenzuar **0.00€** ose **0.00%** të mjeteve të alokuara – pranuar.
- Ne përgjithësi në këtë periudhë Janar - Mars 2024 vlen të përmendet efikasitet mesatar në menaxhimin e buxhetit (pagesa) **46.12%** e mjeteve të alokuara buxhetore, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023 kemi shpenzime me të larta prej **17.58%**.

❖ **TË HYRAT BUXHETORE PERIODIKE JANAR - MARS 2024**

- **Të Hyrat Vetanake:** Komuna ka realizuar të hyra vetanake në periudhën Janar - Mars 2024, me donacione 35,467.47€ ose 3.75% të alokimeve prej 946,766.71€.
- **Pengesat që kanë ndikuar në rezultate edhe më të mëdha janë:**
 1. Grandi Qeveritar jo i mjaftueshëm për realizimin e aktiviteteve të parapara nga Komuna dhe kufizimet në planifikimin e shpenzimeve operative.

Duke pasur parasysh indikatorët e lartë cekur Komuna e Junikut, në Periudhën Janar –Mars 2024 ka arritur rezultate të mira të cilat u bënë të ditura më lartë.

ZKF
Arten Hamza

Drejtori Buxhet e Financa
Vjollca Qestaj

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu



REPubLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA JUNIK
 OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-03/24
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	29.03.2024
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së tretë (03) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 29.03.2024, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, Kryetarin e Komunës së Junikut z. Ruzhdi Shehu, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit me pas konstatoi se mbledhje marin pjesë të 12 anëtarët e kuvendit. Në mbledhje nga drejtorët prezent ishin: znj. Leonora Shehu-AD, znj. Vjollca Qestaj, z. Xhavit Velijaj DAKRS, z. Fatos Shala-DSHMS dhe z. Zenun Shala DUKM, z. Demokrat Ganijaj DSHPMIS.

Anëtarët prezent

- | | |
|---|---|
| <ol style="list-style-type: none"> 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK 4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK 5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK 7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK | <ol style="list-style-type: none"> 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK 11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK 12. Festina Maloku - Anëtare, AAK 13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV 14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV 15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV |
|---|---|

Rendi i ditës i paraparë

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftesi të Kufizuara,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komiteti Konsultativ për Persona me Aftesi te Kufizuara,
5. Njoftim mbi shfrytezimin e pronave Komunale,
6. Inicim i procedurave për hartimin e Strategjisë për Komunikim dhe Marëdhënie me Publikun,
7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit, dhe
8. Të ndryshme.

Rendi i dites miratohet me 12 vota per, 0 vota kunder, dhe 0 vota abstenim

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,

z.Shpejtim Gacaferi, ne mbledhjen e Marsit-2024 mungojnë, znj.Lirjeta Shehu (LDK), z.Lulzim Gacaferi (LVV), dhe z.Dervish Bajraktari (AAK).

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka, e qes ne votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar, kush është për? për 12 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesvebali nga mbledhja e kaluar u miratua.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftesi të Kufizuara

Raportin e punes se KKPAK, nuk e prezentoj askush, mirë për çdo pyetje nga anëtarët e kuvendit ne sallën e kuvendit ishte prezent Kryesuesi i ketij Komiteti z.Beqë Knushi.

z.Shapejtim Gacaferi, kerkesë nuk ka e qes ne votim raportin e punës se KKPAK, kush është për? për 12 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se raporti i punës se KKPAK u miratua.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komiteti Konsultativ për Persona me Aftesi te Kufizuara,

Plani e punës se KKPAK, nuk e prezentoj askush, mirëpo per çdo pyetje nga anëtarët e kuvendit prezent ne sallën e kuvendit ishte Kryesuesi i keti komiteti, z.Beqë Knushi.

z.Shpejtim Gacferi, kerkese nuk ka, e qes ne votim plani e punes se KKPAK, kush eshte per, per 12 vota, kunder 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se plani i punes se KKPAK u miratua.

5. Njoftim mbi shfrytezimin e pronave Komunale,

Njoftimi e beri z.Zenun Shala drejtor ne DUKM, i cili fillimisht i pershendeti te gjithë më pas e njoftoj Kuvendin lidhur me dhënien e pronave publike në shfrytëzim.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese nuk ka, kalojmë në pikën e radhës së rendit të ditës.

6. Inicim i procedurave për hartimin e Strategjisë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun,

Sqarimin dhe arsyetimin e strategjisë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun e bëri znj.Leonora Shehu, drejtoreshne ne AD, e cila fillimisht i pershendeti te gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoj hartimin e strategjise për komunikim dhe marrëdhënie me publikun para anëtarëve te kuvendit.

z.Leonard Lolluni, pershendetje për të gjithë, ne nuk morem kurrfarë sqarimi nga drejtoresha për këtë inicim.

znj.Leonora Shehu, ne si komunë kemi marë një rekomandim nga ministria e pushtetit lokal, për ta hartuar këtë strategji, andaj ne kërkojmë nga ju qe ta miratoni kërkesën tonë që ne te mund të fillojmë me procedurat, deri më tani komuna e jonë nuk ka patur një strategji te tillë.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese tjeter nuk ka e qes ne votim hartimin e strategjisë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun kush është për? për 12 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota konstatoi se inicimi i hartimin i strategjine për komunikim dhe marrëdhënie me publikun u miratua.

7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit,

Nuk pati pyetje nga anëtarët e kuvendit.

8. Të ndryshme.

z.Mursel Salihaj, përshëndetje për të gjithë, çështja që do ta ngriti ka të bëjë një operator që operon e në lumin erenik, me sa jam në dijeni ky operator ka një kontratë me një qytetarë që të operoj vetëm në pronën e këtij qytetari në pronë private të tij, mirëpo operatori ka dalur edhe në shtratin e lumit erenik dhe ka vendosur disa shtylla të betonit dhe qytetarët e anës së kundërt të shtratit erenik po shqetsohen se me rritjen e ujit në shtratin e lumit erenik, do të kenë dëme në pjesën e tyre të pronës sepse këto shtylla do të ja ndërrojnë rrjedhen e lumit. Ky operator ndoshta ka leje që te operoj në pronën private por nuk e di se a ka leje të operoj edhe ne lumin erenik, andaj unë kërkojë që kjo çështje te shiqohet nga drejtorja përkatëse dhe te merrë masa ndaj këtij operatori.

z.Demokrat Ganijaj, përshëndetje për te gjithë, ne kemi qenë në vend ku operon ky operator dhe asnjëherë nuk e kemi gjetur duke punuar, pjesa ne fjale eshte jashte pjesë urbane te komunës

sonë dhe realisht ne si komunë nuk kemi te drejtën e menagjimit ne atë pjesë sepse atë pjesë e menaxhon departamenti i minierave, ne ju kemi drejtuar dy apo tri shkresa lidhur me këtë çështje inspektorëve të këtij departamenti dhe kane ardhur e kan inspektuar dhe na kanë thënë se nuk e kanë gjetur duke punuar.

z.Ruzhdi Shehu, pershendetje për të gjithë, është shqetësim i ngritur me vend, ne nuk kemi pasur informacion te tillë, andaj mendoj se duhet ta bëjmë një shkresë pergjegjsve që e kanë lëshuar lejen për shfrytëzimin e asaje pjese për atë veprimtari dhe duhet te krijohet nje mekanizëm i perbashket per të inspektuar atë pjesë, sepse nëse ka ndërhyrje në shtratin e lumit erenik në njëren anë atëherë do ta dëmtojë anën e kundërt të lumit dhe keshtu e ndryshon rrjedhën e lumit.

z.Leonard Lolluni, qeshtja ime ka te beje me menaxhimin e mbeturinave, fjala është për deponitë ilegale, kohës së fundit në pjesën ka shkoza nuk është qe është duke u inspektuar shumë ajo pjesë nga ana e komunës dhe me e keqja është se afër varrezave ka qe hudhin mbeturina.

z.Demokrat Ganijaj, ne jemi duke përgatitur projektin për deponitë inerte, dhe ne e kemi inspektuar atë pjesë dhe kemi shqiptuar një gjobë, por do të ishte mirë që çdo kush qe hasë ne këta persona qe hudhin mbeturina te na informojnë ose të bëjnë se paku një foto dhe ne do ti marim masat ndaj tyne.

z.Xhemë Tofaj, pershendetje per te gjithë, çështja ka te bëjë me shëndetësi, para dy ditëve patëm një rast dhe ne deshëm që të thërrasim ne telefon emergjent në QKMF, dhe nuk pati qasje dhe na është dashur te thërrasim policinë që të na vinë në ndihmë, unë dua që këtë çështje ta ngris qe edhe QKMF_ja te këtë një numër telefoni emergjent siç e ka policia qe kur te kanë nevojë qytetarët të thërrasin ne këtë numër.

z. Fatos Shala, përshëndetje për te gjithë, ne fakt numrin e kanë dhe unë do te shikoj se perse nuk ka funksionuar dhe do të informoj se pse nuk paska funksionuar telefoni?

Z,Shpejtim Gacaferi, çështje tjetër nuk ka, me kaq e shpalli te mbyllur mbledhjen e Marsit-2024

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR SHERBIME PUBLIKE



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK-OPSTIANA JUNIK-MUNICIPALITY OF JUNIK

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji nr.03/L-040,GZRK nymër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statusit të Komunës së Junikut (Vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numer 002/01 i datës 01.02.2019) dhe Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, Kryesuesja e Komitetit për Sherbime Publike bënë këtë:

Raport:

Vendi: Komuna e Junikut

Hartuesi: Komiteti për Sherbime Publike

Lloji i punës: Raport Pune

Junik, prill 2024

“RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2023”

Komiteti për Shërbime Publike në kuadër të Kuvendit të Komunës së Junikut me qëllim të realizimit të detyrave të punës në përputhje me Rregulloren e punës së komiteteve dhe në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale për vitin 2023 harton këtë:

RAPORTI I PUNËS

Komiteti për Shërbime Publike është organ i formuar nga Kuvendi i Komunës së Junikut në harmoni me statutin e Komunës së Junikut dhe Rregullores se punës së Kuvendit.

Misioni:

Është komitet jo obligativ ndihmës i Kuvendit i themeluar me vendim të Kuvendit Komunal të Junikut.

Ky komitet si qëllim primar ka përmirsimin e kushteve jetësore për qytetaret, mbrojtjen e sipërfaqeve publike dhe pamjen sa më të bukur të qytetit dhe vendbanimeve të tjera. Ky komitet ka një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe ruajtjen e mjedisit të përbashkët.

Komiteti për Shërbime Publike numëron gjithsej 5 antarë prej te cileve 3 antarë janë femra dhe 2 meshkuj. Në komitet është një përfaqësues i subjektit politik i LDK-së, një përfaqësues i subjektit politik i AAK-së dhe një përfaqësues i subjektit politik i LVV-së. Dy antarët e tjerë janë profesionist në fushat që ndërlidhet profesioni i tyre me punën e këtij komiteti.

Gjatë vitit 2023 Komiteti për Shërbime Publike ka mbajtur gjithsej 4 mbledhje të rregullta.

Në të gjitha mbledhjet ka mbizotëruar fryma e arsyes dhe janë trajtuar çështje me rëndësi .

RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR SHERBIME PUBLIKE

Aktivitetet që anëtarët e Komitetit për Sherbime Publike gjatë vitit 2023 kanë shtjelluar temat me sa vijon:

Muaji: Agjenda:

Qershor

1. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komitetit për Sherbime Publike për vitin 2023;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Orarit të mbajtjes së takimeve të Komitetit për vitin 2023, datat dhe ora;
3. Të ndryshme.

Korrik

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë mbi sektorin e emergjencave në Komunen e Junikut;
3. Informatë mbi gjendjen e furnizimit me ujë të pishëm dhe amviseri në Komunen e Junikut;
4. Të ndryshme.

Shtator

RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR SHERBIME PUBLIKE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave ;
3. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit në Komunën e Junikut;
4. Takim publik me qytetaret rreth problemeve të Sherbimeve Publike;
5. Të ndryshme.

Tetor

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë mbi menaxhimin e hapsirave publike;
3. Të ndryshme.

Nentor

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë mbi ndriqimin publik;
3. Të ndryshme.

Dhjetor

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Hartimi i planit të punës së Komitetit për Sherbime Publike për vitin 2024;
3. Informatë rreth funksionimit të rrjeteve të kanalizimit të ujrave të ndotura dhe atmosferike në komunën e Junikut.

4. Të ndryshme.

AKTIVITETE TJERA:

Shiqimi i mundësisë për bashkëpunimin me Organizata të ndryshme të huaja dhe vendore për të sjellur investime që nderlidhen me shërbimet publike në komunën tonë .

Informimi

Komiteti, përveq se për punën dhe aktivitetet e veta i raporton me shkrim Kuvendit Komunal të Junikut në baza vjetore dhe përmes raportimit për një temë të veçantë mbi komunitetin e aftësisë së kufizuar, për transparencë dhe për informim të drejtë të palëve të interesit:

- **Komiteti, tërë punën dhe aktivitetet e veta i publikon në Faqen Zyrtare të Komunës së Junikut , si dhe**

REZYMEJA E RAPORT-PROGRAMIT

Me realizimin e këtijë raport-programi vie gjer tek ngritja e kapacitetit dhe efikasitetit të punës së Komitetit, Kuvendi Komunal dhe Drejtoria per Sherbime Publike të kenë perkrahjen profesionale nga ana e anëtarëve të Komitetit.

Në kuader të Komitetit ka anëtar profesionistë në lëmin e Planifikimit Hapsinor dhe Projektimit.

Kryesuesja e KSHP
Znj. Festina Maloku
